

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL - IEKA


LETRA PËR DREJTIMIN

31 DHJETOR 2023

Për: Z. Doranian Agalliu, Drejtor Ekzekutiv
Z. Berti Pashko, Kryetar i Këshillit të Drejtimit

Addressa: Rr. Elbasanit, Pallati EDIL-AL-IT. PO Box 1437. Tirane

Tiranë 29 Prill 2024



PËRMBAJTJA

PËR DREJTIMIN E INSTITUT TË EKSPERTËVE KONTABËL – IEKA	3
A – Çështje nga viti i kaluar	4
B – Çështje të vitit aktual	6

PËR DREJTIMIN E INSTITUT TË EKSPERTËVE KONTABËL – IEKA

Të nderuar;

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (që këtu e tutje “IEKA”) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Ne kemi marrë në konsideratë sistemin e kontrollit të brendshëm për të planifikuar dhe kryer procedurat tona të auditimit në mënyrë që të shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të IEKA. Një auditim nuk përfshin rishikimin e efektivitetit të funksionit të të gjithë sistemit të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, ne nuk e kemi konsideruar sistemin e kontrollit të brendshëm pas datës së raportit tonë.

Gjatë auditimit tonë ne kemi identifikuar disa çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e politikave të kontabilitetit dhe përgjegjësitë e drejtuesve për paraqitjen e pasqyrave financiare. Këto çështje mund të kenë një efekt negativ në aftësitë e Organizatës për të regjistruar, përpunuar, përmbledhur dhe publikuar të dhënat financiare të sakta për anëtarët, publikun dhe agjencitë monitoruese.

Çështjet e identikuara janë marrë në konsideratë gjatë përcaktimit të natyrës, kohëzgjatjes dhe fushëveprimit të procedurave të zbatuara gjatë auditimit të pasqyrave financiare të IEKA për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023.

Ky raport ka për qëllim vetëm informacionin dhe përdorimin e tij nga Drejtuesit e IEKA dhe nuk duhet të përdoret nga askush tjetër përveç palëve të specifikuara.

Me respekt,

Arjan
UHY Elite sh.p.k.
The Auditor



A – ÇËSHTJE NGA VITI I KALUAR

Nr.	Çështjet e adresuara implikimet e mundshme	Statusi këtë vit	Përgjigja / komentet nga drejtuesit	Niveli i rrezikut ¹ L / M / U
1.	Korrigjimi i veprimeve të gabuara nga e kaluara. Ashtu sikurse përshkruhet në shënimin nr. 12 të Pasqyrave Financiare të IEKA, drejtuesit e IEKA kanë filluar një analizë të detajuar të regjistrimeve kontabël të periudhave të kaluara, duke zbatuar dhe rekomandimet e Komitetit të Kontrollit të brendshëm datë 8 Qershor 2023. Si rezultat i kësaj pune janë konstatuar gabime të periudhave të kaluara me një efekt neto në rritje të aktiveve neto prej 4,556,056 Lek. Midis të tjerash, janë fshirë disa të drejta kundrejt anëtarëve të IEKA të cilët ose nuk jetojnë më, ose janë larguar nga IEKA shumë kohë më parë në shumën 813,929 Lek. Drejtuesit nuk kanë marrë një aprovim nga Këshilli Drejtues për të fshirë këto të drejta. Rekomandimi: Në këto kushte, edhe pse rezultati do ishte i njëjtë, drejtuesit duhet të krijojnë një provizion për të njëjtën shumë të cilin do rëndonte rezultatin e vitit 2022 dhe nuk do kalonin direkt si gabime të periudhave të kaluara nëpërmjet ndryshimeve në Aktivet neto të Organizatës.	E zgjidhur	Këshilli Drejtues nuk ka arritur të marrë një vendim për këtë çështje, dhe drejtuesit nuk e kanë parë të arsyeshme të ndryshojnë veprimin pasi rezultati do ishte i njëjtë dhe në fund të ditës Aktivet neto të Organizatës do pakësoheshin me të njëjtën shumë.	U
2.	Llogaritë e arkëtueshme. Ashtu sikurse përshkruhet në Opinionin me rezervë dhe në shënimin nr. 5 dhe 7 të Pasqyrave Financiare të IEKA, drejtuesit e Organizatës kanë ndërmarrë një operacion të gjerë për identifikimin, konfirmimin dhe vlerësimin e llogarive të arkëtueshme nga anëtarët e Organizatës.	Në Proces	Drejtuesit kanë hartuar listat dhe kanë filluar të dërgojnë kërkesa për konfirmim tek Anëtarët dhe tek Stazhierët. Arsye e vonese, ka qenë sezoni Janar-Mars 2024, ku pritshmëritë për përgjigje nga Anëtarët ishte me e ulët.	L

¹ Niveli Rrezikut L = Lartë; M = Mesatar; U = Ulët.

Nr.	Çështjet e adresuara implikimet e mundshme	Statusi këtë vit	Përgjigja / komentet nga drejtuesit	Niveli i rrezikut ¹ L / M / U
	Deri në datën e lëshimit të raportit të auditimit për vitin 2022 (29 Prill 2024), ky proces nuk kishte përfunduar, dhe për pasojë saktësia e shumës së paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të Organizatës nuk ishte e mundur të vërtetohej. Për këtë arsye u lëshua një opinion me rezervë. Rekomandimi: Drejtuesit e IEKA duhet të kontaktojnë të gjithë anëtarët dhe stazhierët dhe të bëjnë verifikimin/konfirmimin e llogarive të arkëtueshme, dhe ti kërkojnë Këshillit Drejtues të bëjë më shumë përpjekje për të mbledhur këto llogari të cilat janë disa vite të vjetra.			
3.	Inventaret. Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të organizatës janë paraqitur inventarë në vlerën 354,576 Lekë të cilat përfaqësojnë koston e librave, revistave dhe botimeve periodike të IEKA, të cilat janë shumë të vjetra dhe vlera e tyre e përdorimit mund të jetë e paqartë. Rekomandimi: Drejtuesit e IEKA duhet të bëjnë një verifikim nëse këto publikime priten të sjellin të hyra në të ardhmen për IEKA, dhe të bëjnë veprimet e duhura sipas rastit.	Në Proces	Drejtuesit do të paraqesin një raport Këshillit Drejtues në lidhje me vlerësimin që drejtuesit kanë për këto inventarë, dhe do të kërkojnë të marrin vendimin e duhur.	M

B – ÇËSHTJE TË VITIT AKTUAL


Nr.	Çështjet për tu adresuar këtë vit dhe implikimet e mundshme	Rekomandimet e Audituesit	Përgjigja / komentet nga drejtuesit	Niveli i rrezikut ² L / M / U
1.	Llogaritë e arkëtueshme. (Vjen nga Viti i kaluar). Sikurse paraqitet në shënimin 5 dhe 7 të pasqyrave Financiare, Drejtuesit e Organizatës nuk kanë përfunduar akoma identifikimin, konfirmimin dhe vlerësimin e llogarive të arkëtueshme nga anëtarët e Organizatës. Deri në datën e lëshimit të raportit të auditimit për vitin 2023 (29 Prill 2024), ky proces nuk kishte përfunduar, dhe për pasojë saktësia e shumës së paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të Organizatës nuk ishte e mundur të vërtetohet. Për këtë arsye u lëshua një opinion me rezervë.	Drejtuesit e IEKA duhet të kontaktojnë të gjithë anëtarët dhe stazhierët dhe të bëjnë verifikimin/konfirmimin e llogarive të arkëtueshme, dhe ti kërkojnë Këshillit Drejtues të bëjë më shumë përpjekje për të mbledhur këto llogari të cilat janë disa vite të vjetra.	Drejtuesit kanë hartuar listat dhe kanë filluar të dërgojnë kërkesa për konfirmim tek Anëtarët dhe tek Stazhierët. Arsye e vonese, ka qenë sezoni Janar-Mars 2024, ku pritshmeritë për përgjigje nga Anëtarët ishte me e ulët.	L
2.	Inventaret. (Vjen nga viti i kaluar). Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të organizatës janë paraqitur inventarë në vlerën 331,398 Lekë të cilat përfaqësojnë koston e librave, revistave dhe botimeve periodike të IEKA, të cilat janë shumë të vjetra dhe vlera e tyre e përdorimit mund të jetë e paqartë.	Edhe pse ka patur disa shitje gjatë vitit 2023, drejtuesit e IEKA duhet të bëjnë një verifikim nëse këto publikime priten të sjellin të hyra në të ardhmen për IEKA, dhe të bëjnë veprimet e duhura sipas rastit.	Drejtuesit do ti paraqesin një raport Këshillit Drejtues në lidhje me vlerësimin që drejtuesit kanë për këto inventarë, dhe do ti kërkojnë të marrin vendimin e duhur.	M

² Niveli Rrezikut L = Lartë; M = Mesatar; L = Ulët.

Nr.	Çështjet për tu adresuar këtë vit dhe implikimet e mundshme	Rekomandimet e Audituesit	Përgjigja / komentet nga drejtuesit	Niveli i rrezikut ² L / M / U
3.	Statusi mbi proceset gjyqësore Sikurse shfaqet në shënimin nr. 20 të pasqyrave financiare, Organizata është e përfshirë në disa çështje gjyqësore si e paditur, dhe ndonjë nga këto çështje mund të rezultojë me vendim në disfavor të Organizatës.	Drejtuesit i Organizatës duhet të vlerësojnë nëpërmjet një konsulentit ligjor, nëse çështjet në gjykatë do të kenë efekte negative financiare në pasqyrat e Organizatës në të ardhmen apo jo, dhe të regjistrojnë provizionet përkatëse për ngjarjet e pritshme.	Drejtuesit do të paraqesin një raport Këshillit Drejtues në lidhje me vlerësimin e çështjeve gjyqësore dhe do të kërkojnë të marrin vendimin e duhur.	M

Nuk ka çështje të tjera për t'u raportuar

Ne dëshirojmë të falënderojmë personelin e IEKA për ndihmesën dhe bashkëpunimin në kryerjen e këtij auditimi.



LET US HELP YOU ACHIEVE FURTHER BUSINESS SUCCESS

UHY Elite offers auditing, accounting, tax consulting and other business advisory services.

NE JU NDIHMOJME QE TE RRISNI BIZNESIN TUAJ.

UHY Elite ofron shërbime auditimi, mbajtje kontabiliteti, konsulence fiskale dhe shërbime të tjera keshillimore.

UHY ELITE SH.P.K K31712103L

Address:

Rruga: "Ibrahim Rugova"

Pallati 17, H3, Apt.12

Tirane, Albania

Tel. +355 4 2237199; +355 4 4502116

www.uhy-elite.com

info@uhy-elite.com

"UHY ELite sh.p.k (the "Firm") is a member of Urbach Hacker Young International Limited, a UK company, and forms part of the international UHY network of legally independent accounting and consulting firms. UHY is the brand name for the UHY international network. The services described herein are provided by the Firm and not by UHY or any other member firm of UHY. Neither UHY nor any member of UHY has any liability for services provided by other members."

"UHY Elite sh.p.k (Firma) është një anëtare e Urbach Hacker Young International (një kompani e regjistruar në Mbretërinë e Bashkuar), dhe është pjesë e rrjetit ndërkombëtar të UHY i cili përfshin firma kontabiliteti dhe konsulencë që janë ligjërisht të pavarura. UHY është marka tregtare e rrjetit UHY International. Shërbimet e përshkruara në këtë material janë ofruar nga Firma dhe jo nga UHY apo nga ndonjë anëtar tjetër i UHY-së. As UHY dhe asnjë nga anëtarët e tjerë të UHY nuk kanë ndonjë përgjegjësi për shërbimet e ofruara nga anëtarët e tjerë"

© 2022 UHY ELITE.

www.uhy-elite.com



INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR

IEKA

**Pasqyrat Financiare
për periudhën që mbyllet më datën
31 Dhjetor 2022**



INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR

Pasqyrat Financiare 31 Dhjetor 2022

Përmbajtja:

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR	3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	6
PASQYRA E BURIMEVE TË FONDEVE	7
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	8
1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME.....	9
3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL.....	9
4. MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTET E TYRE	11
5. LLOGARI TË ARKËTUESHME	12
6. INVENTARËT	12
7. TË TJERA TË ARKËTUESHME (KUOTA VARIABËL).....	13
8. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE.....	13
9. LLOGARI TË PAGUESHME DHE DETYRIME	14
10. DETYRIME TATIMORE	14
11. TË ARDHURA TË PERIUDDHVE TË ARDHSHE	15
12. NDRYSHIME NË PASURINË NETO	15
13. BURIMET E FONDEVE NGA VEPRIMTARIA KRYESORE	16
14. PAGAT DHE SIGURIMET SHOQËRORE TË PERSONELIT	16
15. HONORARE TË DREJTIMIT, AUTORITETE, KOMITETE	16
16. SHPENZIME ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA	17
17. BURIMET DHE SHPENZIMET PËR KUALIFIKIMIN EKR & STAZHIERËVE	17
18. TEPRICA NETO E BURIMEVE TË VITIT.....	17
19. DETYRIME TË MUNDSHME.....	18
20. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT.....	18

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

PËR: ORGANIZATËN JO-FITIMPRURËSE "IEKA"

Opinion me Rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Organizatës Jo-Fitimprurëse Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar "IEKA" të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2022, pasqyrën e aktiviteteve, pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme. Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Organizatës më datën 31 Dhjetor 2022, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK)për OJF-të.

Baza për Opinionin me Rezervë

Siç theksohet në shënimin shpjegues nr. 5 Organizata ka paraqitur në llogari të arkëtueshme nga Anëtarët për kuotën fikse dhe stazhierët në shumën 10,013,983 Lek, për të cilat ne nuk ishim në gjendje të merrnim siguri të mjaftueshme në lidhje me ekzistencën dhe vlerësimin e kësaj shume në Aktivët e Pozicionit financiar të Organizatës. Drejtuesit kanë filluar një proces rakordimi me të gjithë anëtarët e Organizatës të cilët kanë teprica të hapura me Organizatën me qëllim saktësimin dhe rakordimin e këtyre tepricave. Procedura e saktësimit dhe rakordimit kërkonte më shumë kohë sesa koha e përcaktuar për kryerjen e auditimit, dhe drejtuesit e Organizatës po punojnë për ta përmbyllur brenda vitit 2024.

Siç theksohet në shënimin shpjegues nr. 7 Organizata ka paraqitur në llogari të arkëtueshme nga Anëtarët për kuotën variabël në shumën 11,175,427 Lek, për të cilat ne nuk ishim në gjendje të merrnim siguri të mjaftueshme në lidhje me ekzistencën dhe vlerësimin e kësaj shume në aktivët e Pozicionit Financiar të Organizatës. Drejtuesit kanë filluar një proces rakordimi me të gjithë anëtarët e Organizatës të cilët kanë teprica të hapura me Organizatën me qëllim saktësimin dhe rakordimin e këtyre tepricave. Procedura e saktësimit dhe rakordimit kërkonte më shumë kohë sesa koha e përcaktuar për kryerjen e auditimit, dhe drejtuesit e Organizatës po punojnë për ta përmbyllur brenda vitit 2024.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbyllur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Përgjegjësitë e Drejtimit në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të për OJF-të dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Organizatës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Organizatën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, të cilat mund të hedhin dyshime të mëdha për aftësinë e Organizatës për të vijuar veprimtarinë. Nëse arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Organizata të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrijnë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtuesit e Organizatës përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Tiranë, më datë 30 Mars 2024



UHY Elite sh.p.k.
Artan Xhiani, Titullues Ligjor

IEKA – INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Më 31 Dhjetor 2022

		Viti i mbyllur 31.12.2022	Viti i mbyllur 31.12.2021
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	83,398,432	82,569,621
Llogari te arkëtueshme	5	10,199,064	10,303,848
Inventarët	6	354,576	354,576
Llogari te arkëtueshme të tjera (kuota variabël)	7	11,175,427	10,107,451
Totali i Aktiveve afatshkurtra (I)		105,127,499	103,335,496
Aktive Afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	31,569,794	31,998,367
Totali i Aktiveve Afatgjata (II)		31,569,794	31,998,367
TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		136,697,293	135,333,863
DETYRIMET DHE PASURIA NETO			
Detyrime			
Llogari te pagueshme	9	5,289,876	10,298,684
Detyrime te tjera (kuota variabël)	7	134,880	545,777
Detyrime tatimore	10	502,864	821,360
Te ardhura te periudhave te ardhme	11	60,000	526,070
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra (I)		5,987,620	12,191,891
Totali i Detyrimeve		5,987,620	12,191,890
AKTIVET NETO	12	130,709,673	123,141,972

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga drejtuesit e shoqatës dhe janë firmosur në datën 30 Mars 2024 nga:

Silda Metani

Silda Metani
2024

Sektori i Financës

Dorani Agallius

Dorani Agallius
Drejtues Ekzekutiv

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare.

IEKA – INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

PASQYRA E BURIMEVE TË FONDEVE

Për periudhën nga 01 Janar 2022 deri më 31 Dhjetor 2022

		Viti i mbyllur 31.12.2022	Viti i mbyllur 31.12.2021
BURIMET E FONDEVE			
Burime nga veprimtaritë kryesore			
Kuotat e anëtarësimit të AL, shoqërive, kandidatëve	13	27,398,673	25,870,212
Të ardhura të tjera	13	130,443	894,610
Burimet nga kualifikimi i EKR & stazhierë	17	2,991,805	2,766,000
Totali i burimeve - të ardhurave		30,520,921	29,530,822
PËRDORIMET E FONDEVE			
Përdorimet për veprimtarinë kryesore			
Pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit	14	(9,702,104)	(5,853,916)
Honorare të Drejtimit, Autoritete, Komitete etj.	15	(6,459,363)	(5,284,000)
Shpenzime administrative dhe të tjera	16	(9,373,690)	(10,128,856)
Shpenzime kualifikimi i EKR & stazhierëve	17	(2,655,594)	(2,249,905)
Totali i përdorimit të fondeve		28,190,751	23,516,677
Teprica e burimeve nga veprimtaria kryesore			
		2,330,171	6,014,145
Humbje nga kursi i këmbimi		(29,725)	(6,006)
Të ardhura nga interesat		711,201	45,000
Të ardhura neto financiare		681,476	38,994
Teprica e burimeve nga veprimtaria kryesore	18	3,011,647	6,053,139
Aktivitetet neto në fillim të vitit			
		123,141,972	117,088,833
Rritje e aktiveve neto nga burime të tjera		4,556,055	-
Aktivitetet neto në fund të vitit		130,709,673	123,141,972

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

IEKA – INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR*(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)***PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE****METODA INDIREKTE****Për periudhën nga 01 Janar deri më 31 Dhjetor 2022**

	Viti i mbyllur 31.12.2022	Viti i mbyllur 31.12.2021
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Përdorime te fondeve per vitin	3,011,646	6,053,139
Rregullime për:		
Amortizimin	1,258,587	1,291,962
Efekti i rregullimit të gabimeve të periudhave të kaluara	4,556,055	
Rritje/rënie në aktivet afatshkurtra	(963,192)	(5,141,854)
Rritje/rënie në detyrimet afatshkurtra	(6,204,271)	5,146,587
Rrjedha e parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit	1,658,825	7,349,834
 Rrjedha e parasë nga veprimtaritë investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(830,014)	-
Rrjedha e parasë e përdorur në aktivitetet investuese	(830,014)	-
 Rrjedha neto e parasë	828,811	7,349,834
 Mjetet monetare në fillim të vitit	4 82,569,621	75,219,787
 Mjetet monetare në fund të vitit	83,398,432	82,569,621

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

1. Informacione të përgjithshme

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (më poshtë "IEKA" ose "Instituti"), është një shoqatë profesionale që grupon Audituesit Ligjorë dhe Shoqëritë Audituese që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë. IEKA është krijuar në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 2 tetor 1995 dhe është regjistruar me Vendimin e Gjykatës së rrethit Tiranë nr. 3573, datë 16 tetor 1998. Instituti ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" (të ndryshuar), si dhe me Ligjin për "Organizatat jo-fitimprurëse" dhe me statutin e tij.

Veprimtaria kryesore e Institutit ka për qëllim të sigurojë që profesioni i Audituesit Ligjor vepron në përputhje me interesat e publikut si dhe të mbrojë etikën dhe pavarësinë e anëtarëve të tij. Veprimtaria e Institutit mbikëqyret nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Selia e Institutit ndodhet në "Rruga e Elbasanit", pallati Edil Al - IT, zyra 321, Tiranë, Shqipëri.

2. Baza e përgatitjes

a. Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Drejtues dhe Asambleja e Përgjithshme për qëllime të raportimit të IEKA si dhe në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jo-fitimprurëse (SKK për OJF) si dhe në zbatim të udhëzuesit të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit për OJF-te, i ndryshuar 2018. Politikat kontabël si më poshtë paraqesin të plotë bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

b. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

c. Vijueshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijueshmërisë. Sipas këtij parimi, IEKA parashikon se veprimtaria e saj do të ketë vijimësi në mënyrë të mjaftueshme që të plotësojë objektivat dhe angazhimet dhe se nuk ka në plan ose nuk do të ketë të nevojshme të ndërpresë aktivitetin e saj në një të ardhme të afërt.

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

a. Monedha funksionale dhe me të cilën paraqiten pasqyrat

Pasqyrat Financiare paraqiten në monedhën vendase Lekë (ALL), e cila është monedha raportuese. Informacioni financiar është paraqitur në Lekë.

b. Njohja e burimeve dhe përdorimit të fondeve

Burimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 janë njohur mbi bazën e parimit të të drejtave të konstatuara, për kuotën fikse vjetore për çdo anëtar dhe për kuotat variabël të llogaritura si përqindje mbi të ardhurat bruto të realizuara nga secili anëtar. Shuma e kuotës fikse është përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të datës 17 dhjetor 2020 (vendimi nr. 146) i cili zbatohet nga 1 janar 2021. Shuma e kuotës fikse për anëtarët që nuk e ushtrojnë profesionin është e përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve me Vendim nr. 107 të datës 28.06.2014. Përqindjet e kuotës variabël janë përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të datës 29 qershor 2017 (vendimi nr. 126) i cili zbatohet që nga 1 janar 2018. Masa e kuotës variabël është 0,5% e të ardhurave totale për nivelin e të ardhurave totale nga 0-8 mln lekë dhe 0.3% e të ardhurave totale për nivelin e të ardhurave totale mbi 8 mln lekë, të cilat janë respektivisht si më poshtë:

	2022	2021
Kuota fikse për anëtar aktiv	60,000	60,000
Kuota variabël	0.5% dhe 0.3%	0.5% dhe 0.3%
Kuota fikse për anëtar pasiv	8,000	8,000

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdon)

Në burimet e Institutit përfshihen edhe të ardhurat nga veprimtari të tjera, siç janë nga kualifikimi i vijueshëm, nga regjistrimet dhe nga anëtarët e rinj si edhe të ardhura të viteve të mëparshme të cilat nuk janë njohur më parë. Për secilën kategori të këtyre burimeve të fondeve është paraqitur edhe shuma përkatëse e përdorimeve. Përdorimet e fondeve të njohura në pasqyrat financiare përfshijnë të gjitha pagesat e bëra gjatë vitit dhe shpenzimet e kryera për vitin por që ende nuk janë paguar në fund të vitit.

c. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen me kursin e datës së kryerjes së transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj janë përkthyer me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në fund të vitit. Diferencat nga kursi i këmbimit të lindura nga përkthimi njihen në pasqyrën e burimeve dhe përdorimit të fondeve. Kursi i këmbimit për dy monedhat e huaja kryesore me monedhën vendase sipas kursit të Bankës së Shqipërisë më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, ka qënë respektivisht si më poshtë:

	2022	2021
1 USD	107.05	106,54
1 EUR	114.23	120,76

d. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare përfshijnë gjëndjen në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në para në banka, të cilat janë për një afat maturimi më pak se një vit. Njohja e interesave të llogaritura mbi depozitat bankare sipas parimit të drejtave të konstatuara.

e. Kërkesa për t'u arkëtuar dhe detyrimet për t'u paguar

Kërkesat për t'u arkëtuar dhe detyrimet për t'u paguar në mbyllje të ushtrimit janë paraqitur sipas vlerës së regjistruar në datën e lindjes së tyre me koston historike.

f. Aktivët afatgjata materiale

Aktivët Afatgjata Materiale (AAM) paraqiten në bilanc me vlerën e tyre bruto minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi është përlllogaritur duke përdorur metodën e amortizimit mbi jetën e dobishme të aktiveve. Për llogaritjen e amortizimit aplikohen norma amortizimi mbi vlerën e mbetur si më poshtë:

Kategoria e aktiveve fikse	2022	2021
Ndërtesa	2%	2%
Mjete transporti	20%	20%
Pasje zyre	20%	20%
Pajisje kompjuterike	25%	25%

g. Teprica e burimeve mbi përdorimet

Teprica midis burimeve dhe përdorimeve që krijohet në ushtrimin kontabël pasqyrohet në pasurinë neto të Organizatës.

h. Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Instituti pagan kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e saj, siç është parashikuar në legjislacionin shqiptar. Organizata nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me fondin për pensione dhe sigurimet shëndetësore.

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

4. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare në banke dhe arkë, në 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021, janë si më poshtë:

Paraja në bankë	Monedhe e huaj	Viti i mbyllur 31.12.2022	Viti i mbyllur 31.12.2021
Intesa SanPaolo (Lekë)		16,286,583	11,187,759
Intesa SanPaolo (Euro)	33.24	3,797	23,333
Shuma ekuivalente në lekë		16,290,380	11,211,092
Banka Kombëtare Tregtare (Lekë)		22,219,227	9,807,874
Banka Kombëtare Tregtare (Euro)	2,097.25	239,569	196,489
Banka Kombëtare Tregtare-Provimet (Lekë)		333,604	121,520
Shuma ekuivalente në lekë		22,792,400	10,125,883
Raiffeisen Bank (Lekë)		280,070	17,705,975
Raiffeisen Bank (USD)	62.61	6,702	13,097
Shuma ekuivalente në lekë		286,772	17,719,072
Depozita me afat 12 Muaj		43,846,055	43,377,666
Totali në Bankë		83,215,607	82,433,713
Paraja ne arkë			
Paraja në Arkë (Lekë)		140,503	97,601
Paraja në Arkë (Euro)	370.50	42,322	38,307
Totali në arkë		182,825	135,908
Totali		83,398,432	82,569,621

Mjetet monetare të investuara në depozita, sipas afatit të maturimit 12 muaj, paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur 31.12.2022	Viti i mbyllur 31.12.2021
Depozita me afat 12 muaj		
Banka Kombëtare Tregtare	16,227,315	16,076,780
Intesa SanPaolo	7,500,000	7,500,000
Credins Bank	20,118,740	19,800,886
Totali	43,846,055	43,377,666

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 të ardhurat nga interesi te njohura janë 711,201 lekë prej të cilave 185,081 lekë priten të arkëtohen në të vitin pasardhës, norma e interesit vjetor per te 3 depozitat bankare është 0.75 %, edhe për vitin pasardhës.

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

5. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë të detajuara si më poshtë:

Përshkrimi	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2021
AL Aktivë për kuotën fikse	5,470,698	5,895,860
AL Pasivë për kuotën fikse	3,426,319	1,835,325
Kërkesa të tjera për t'u arkëtuar	-	1,678,963
Të drejta ndaj stazhierëve ndër vite	1,116,966	760,750
Interesa aktive të llogaritura	185,081	-
Detyrime për aktivitete	-	132,950
	10,199,064	10,303,848

Kuotat fikse të anëtarëve AL janë në vlerën 8,897,017 lekë nga të cilat 5,470,698 lekë janë kuota fikse e anëtarëve aktiv të cilët e ushtrojnë profesionin, kuota fikse përpjesëtimore, penaltitete të cilët nuk kanë përmbushur detyrimin e tyre ndër vite sipas statutit, dhe shuma 3,426,319 lekë përfaqëson kuotën fikse të anëtarëve të cilët nuk e ushtrojnë më profesionin dhe të pa arkëtuar ende. Kuota fikse e anëtarëve aktiv është në shumën 60,000 lekë kurse kuota fikse e anëtarëve pasiv është 8,000 lekë.

Të drejtat ndaj stazhierëve janë rritur në shumën 356,216 Lek të cilat nuk janë arkëtuar gjatë vitit 2022, dhe vlera 1,116,966 lekë përfaqëson shumën të cilat nuk janë arkëtuar ndër vite nga stazhierët e praktikës profesionale. Interesat aktive të llogaritura në vlerën 185,081 lekë janë të ardhura të cilat janë njohur më 31.12.2022 por që priten të arkëtohen në periudhën pasardhëse dhe i përkasin 3 depozitave bankare.

Drejtuesit kanë filluar një proces rakordimi me të gjithë anëtarët e Organizatës për të saktësuar detyrimet e anëtarëve dhe për mbledhjen e këtyre detyrimeve sipas përcaktimeve në statutin e Organizatës.

6. Inventarët

Inventarët e botimeve janë të përbërë si më poshtë:

Përshkrimi	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2021
Kodi Etikës	910	910
SNA	12,480	12,480
Guida	67,950	67,950
Revista	52,334	52,334
Udhërrëfyesi	89,880	89,880
SNA mbi raportin e auditorit të pavarur	83,640	83,640
Të tjera	47,382	47,382
Totali	354,576	354,576

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

7. Të tjera të arkëtueshme (kuota variabël)

Të arkëtueshme të tjera përfaqësojnë të drejtat e Institutit ndaj anëtarëve të tij në lidhje me kuotën variabël si më poshtë:

Përshkrimi	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2021
Te drejta për kuotën variabël	11,175,427	10,107,451
Detyrime për kuotën variabël	(134,880)	(545,777)
Pozicioni neto	11,040,547	9,561,674

Këto të drejta lindin kur anëtarët e Institutit kanë paguar më pak se misionet e deklaruar.

Llogari të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2022 janë 11,175,427 Lekë (31 dhjetor 2021: 10,107,451 Lekë) e cila pritet të arkëtohet në vitin pasardhës.

Detyrime të tjera përfaqësojnë detyrimet e Institutit ndaj anëtarëve të tij për kuotën variabël. Këto detyrime lindin kur anëtarët e Institutit kanë paguar më shumë se misionet e deklaruar. Detyrimet për kuotën variabël më 31 Dhjetor 2022 janë 134,880 Lekë (31 dhjetor 2021: 545,777 Lekë).

Drejtuesit kanë filluar një proces rakordimi me të gjithë anëtarët e Organizatës për të saktësuar detyrimet e anëtarëve dhe për mbledhjen e këtyre detyrimeve sipas përcaktimeve në statutin e Organizatës.

8. Aktivet afatgjata materiale

	Ndërtesa	Mjete transporti	Pajisje Zyre	Pajisje Informatike	Te tjera AAM	Total
Kosto më 31 Dhjetor 2021	47,455,444	3,273,550	10,253,864	1,020,803	-	62,003,661
Rregullime dhe riklasifikime nga inventarizimi (*)			(4,357,102)	4,974,762	-	617,660
Shtesa			44,582	8,483		53,065
Kosto më 31 Dhjetor 2022	47,455,444	3,273,550	5,941,344	6,004,048	-	62,674,386
Amortizimi i akumuluar						
Më 31 dhjetor 2021	16,136,944	3,273,550	9,687,563	-	907,237	30,005,294
Rregullime dhe riklasifikime nga inventarizimi		(663,629)	(4,299,820)	5,711,397	(907,237)	(159,289)
Shtesa	949,408	132,726	103,290	73,163	-	1,258,587
Më 31 dhjetor 2022	17,086,352	2,742,647	5,491,033	5,784,560	-	31,104,592
Vlera Neto Kontabël						
Më 31 Dhjetor 2021	31,318,500	-	566,300	1,020,803	(907,237)	31,998,367
Më 31 Dhjetor 2022	30,369,092	530,903	450,311	219,488	-	31,569,794

(*) Rregullimet kanë të bëjnë me një inventarizim të aktiveve afatgjatë dhe nevojën për një rregullim në riklasifikim të tyre pas inventarizimit.

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

9. Llogari të pagueshme dhe detyrime

Llogaritë e pagueshme ne datën 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 përbëhen nga:

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2021
Këshilli i Drejtimit	212,500	690,396
Këshilli i Drejtimit mbledhje	179,350	-
Komiteti i Edukimit Kualifikimit te Vijueshëm	43,350	435,000
Komiteti i Regjistrimit	53,550	-
Komiteti i Kontrollit te Brendshëm	255,000	-
Komiteti i Standardeve Profesionale dhe Etikes	57,800	-
Komiteti i Programeve alternative dhe Metodologjisë se Auditimit	53,551	-
Komiteti i Kontrollit te Cilësisë	-	707,885
Nen-total	855,101	1,833,281
Përshkrimi		
EDIL AL-IT për punime të zyrave të reja	-	178,494
Detyrime ndaj punonjësve	400,218	49,989
Alpas 2E shpk (Hilton Hotel)	567,933	-
Detyrime për trajnerët	481,500	5,395,960
Fatura utilitiare per tu paguar	29,365	-
Detyrime ndaj te treteve	70,000	1,135,745
Fond i veçante per ndihma	300,000	-
Detyrim për tarifen 7% për BMP	2,585,759	1,705,215
Nën-totali	4,434,775	8,465,403
Totali	5,289,876	10,298,684

Vlera 855,101 lekë është totali i detyrimeve sipas komiteteve përkatëse dhe priten të shlyhen në periudhën pasardhëse.

10. Detyrime tatimore

Llogaritë e pagueshme ne datën 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 përbëhen nga:

Përshkrimi	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2021
Shteti tatime taksa (TAP)	44,961	713,063
Shteti tatime taksa Tatim ne Burim	305,223	-
Sigurime shoqërore	152,680	108,297
	502,864	821,360

Vlera 502,864 lekë përbëhet nga detyrimet ndaj tatim-taksave për muajin dhjetor 2022 të cilat janë shlyer në janar 2023.

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

11. Të ardhura të periudhave të ardhshme

Të ardhura të periudhave të ardhme në datën 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 përbëhen nga:

Përshkrimi	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2021
Kuota anëtarësie të marrë në avancë	60,000	526,070
	60,000	526,070

12. Ndryshime në pasurinë neto

Pasuria neto e Organizatës paraqitet si më poshtë:

	Të pakufizuara	TOTAL
Teprica në 31.12.2021	123,141,972	123,141,972
Rritja nga aktiviteti ushtrimor	3,011,647	3,011,647
Rritja nga burime të tjera	4,556,055	4,556,055
Balanca mbyllëse në 31.12.2022	130,709,674	130,709,674

Rritja nga burime të tjera, në shumë 4,556,055 Lek vjen si rezultat i disa veprimeve dhe korrigjimeve të gabimeve të viteve të kaluara:

Përshkrimi	Efekti në Rritje / (Rënie)
1 Nga verifikimet e bëra, janë anuluar disa detyrime që Organizata kishte ndaj anëtarëve të saj të cilët nuk jetojnë ose nuk janë anëtarë efektivë prej një kohe të gjatë.	353,126
2 Nga verifikimet e bëra, janë anuluar disa të drejta të pa arkëtueshme prej anëtarë të organizatës të cilët nuk jetojnë ose nuk janë anëtarë efektivë prej një kohe të gjatë.	(813,929)
3 Nga verifikimet e bëra, janë anuluar disa detyrime të hershme të Organizatës me palët të treta, të cilat nëpërmjet konfirmimit direkt, rezultoi se ishin të likuiduara më parë.	4,455,142
4 Nga verifikimet e bëra, janë shtuar disa Aktive të Organizatës dhe rillogaritur amortizimet përkatëse, të cilat nuk janë regjistruar më parë.	776,949
5 Nga verifikimet e bëra, janë anuluar disa të drejta të hershme të Organizatës me palët të treta, të cilat nëpërmjet konfirmimit direkt, rezultoi se ishin të arkëtuara më parë.	(132,950)
6 Janë bërë korrigjime të paraqitjeve të gabuara të pasqyrave financiare në vitin 2021 në shumën.	(82,282)
Rritje në Pasurinë neto	4,556,056

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR**Shënime për pasqyrat financiare****31 Dhjetor 2022***(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)***13. Burimet e fondeve nga veprimtaria kryesore**

Përfaqësojnë të ardhurat nga grantet, donacionet dhe kuotat e anëtarësisë.

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2021
Nga kuota fikse AI-ve	14,653,388	14,365,000
Nga kuota variabël e AI-ve	9,602,101	8,762,712
Nga kuota fikse ALve Pasive	1,346,674	1,232,500
Nga kuota e regjistrimit në praktiken profesionale	1,334,010	1,275,000
Nga kuota e regjistrimit të shoqërive	462,500	235,000
Të ardhura të tjera	130,443	894,610
	27,529,116	26,764,822

Të ardhurat nga kuota fikse AL përfaqësojnë burimet nga kuota fikse prej 60,000 lekë dhe kuota fikse përpjesëtimore për të gjithë anëtarët aktiv.

Të ardhurat nga kuota variabël përfaqësojnë të ardhurat sipas deklarimit të misionëve të AI-ve për vitin 2022 për të cilët deklaruan gjithsej 157 anëtarë persona fizik dhe 55 shoqëri auditimi.

Të ardhurat nga kuota e anëtarëve pasiv përfaqëson shumën e arkëtuar gjatë vitit 2022, e cila është 8,000 Lek në vit për çdo anëtar pasiv. Të ardhurat të tjera përfaqëson të ardhurat nga lëshimi kërkesave për vërtetime..

14. Pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit

Përfaqëson pagat e personelit dhe kontributet për sigurime shoqërore për punonjësit e IEKA. Në fund të vitit 2022 IEKA ka 6 punonjës me kohë të plotë (2021 kishte 5 punonjës me kohë të plotë).

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2021
Pagat e personelit	7,974,003	5,103,201
Kontribute për sigurime shoqërore	1,251,630	750,715
Të tjera	476,471	-
	9,702,104	5,853,916

15. Honorare të Drejtimit, Autoritete, Komitete

Përfaqëson pagesat për honorarë të anëtarëve të institucioneve të IEKA.

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2021
Honorare drejtimi dhe tarifa	4,793,818	4,834,000
Honorare për Autoritetin e Regj. dhe komitete	1,665,545	450,000
	6,459,363	5,284,000

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

16. Shpenzime administrative dhe të tjera

Përfaqësojnë shpenzimet administrative të Organizatës, si më poshtë:

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	1,258,587	1,291,962
Kuota regjistrimi në organizma Profesionale	742,156	1,736,000
Udhëtime e dieta	1,241,977	
Telefon, internet, mirëmbajtje e faqes në web.	559,753	365,672
Utilitete	206,055	328,625
Kancelari, mirëmbajtje	486,340	85,725
Shpenzime për konsulencë ligjore	1,248,980	-
Shpenzime për Asamblenë	1,008,605	-
Shpenzime konferenca 25 Vjetori IEKA	798,433	-
Shpenzime te tjera	942,260	4,615,657
Shpenzime për tarifën 7% për BMP	880,544	1,705,215
	9,373,690	10,128,856

17. Burimet dhe shpenzimet për kualifikimin EKR & stazhierëve

Përfaqësojnë burimet dhe përdorimin e fondeve për kualifikimin e EKR-ve dhe të stazhierëve.

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2021
Burimet e fondeve nga kualifikimi AL	172,000	570,000
Burimet e fondeve nga kandidatët	2,819,805	2,196,000
Totali i burimeve	2,991,805	2,766,000
Përdorimet e fondeve për kualifikimin e AL	(714,750)	(509,853)
Përdorimet e fondeve për kualifikimin e kandidatëve	(1,940,844)	(1,740,052)
Totali i përdorimeve	(2,655,594)	(2,249,905)
Teprica	336,211	516,095

18. Teprica neto e burimeve të vitit

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2021
Teprica e Burimeve		
Teprica nga aktiviteti	1,993,960	5,498,050
Teprica nga kualifikimet	336,213	516,095
Të ardhura financiare	681,476	38,994
Teprica	3,011,647	6,053,139

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

19. Detyrime të mundshme

IEKA është angazhuar në ndjekjen e disa rasteve të padive të ngritura prej saj si palë paditëse dhe të disa rasteve si palë e paditur, objekti i të cilave ka të bëjë me aktivitetin operacional të organizatës. Drejtuesit nuk kanë siguri të mjaftueshme për vlerësimin e detyrimeve të mundshme që mund të lindin nga proceset e ngritura. Proceset e ngritura nuk kanë ndikuar dhe nuk do të ndikojnë në vijimësinë e aktivitetit.

20. Ngjarje pas datës së raportimit

Pas datës 31.12.2022 nuk ka pasur ngjarje materiale të cilat mund të ndikojnë në vazhdimësinë e aktivitetit të organizatës.

Silda Metani



Spektori i Financës



Doranin Agalliu



Drejtör Ekzekutiv